

VENDIM
Nr. 109, datë 27.3.2023

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE (KESH) SHA”, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TEC-i LUNDRUES I INSTALUAR NË PORTIN E TRIPORTIT NË GJIRIN E VLORËS

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 308/11 prot., datë 24.3.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë KESH sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC i lundrueshëm i instaluar në portin e Triportit në Gjirin e Vlorës”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 350, datë 28.12.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a.”, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-i lundrues, i instaluar në Portin e Triportit në Gjirin e Vlorës, i përbërë nga dy gjenerues Tigr 1 dhe Tigr 3, për një afat 2-vjeçar (dyvjeçar).

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.12.2022 dhe 31.12.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 28.1.2023, periudha e pritjes së komenteve është 30 ditë pasi TEC-i është i lidhur në OST), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 55, datë 24.2.2023, vendosi të zgjasë me 30 ditë vendimmarrjen e tij, në lidhje me licencimin e shoqërisë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare” (KESH) sh.a., pasi u konstatua se shoqëria dokumentoi në ERE se ishte pajisur me miratimin paraprak të pikës së lidhjes e ishte në proces për miratimin e marrëveshjes së lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe kishte aplikuar për marrjen e lejes së përdorimit të burimit ujor.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin nr. 350/2022 me shkresën nr. 2074/3 prot., datë 30.12.2022, dhe e ka kujtuar për plotësimin e dokumentacionit të munguar, me shkresën me nr. 308/2 prot., datë 7.1.2023. KESH sh.a. ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresën nr. 308/1 prot., datë 1.2.2023, nr. 308/6 prot., datë 24.2.2023, nr. 308/9 prot., datë 20.3.2023, dhe nr. 308/10 prot., datë 24.3.2023.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria KESH sh.a. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a” dhe “c”; për pikën 2.1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”.

- Në kuadër të mbikëqyrjes dhe të zbatimit të kushteve të licencës, shoqëria të depozitojë në ERE pasqyrat financiare të vitit 2020 dhe vitit 2021, brenda datës 31.7.2023.

- Në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ERE lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se kontrata e qirasë për prodhimin e energjisë elektrike nga impianti termik Tigër 1 dhe Tigër 3, është nënshkruar për një periudhë 2-vjeçare (dyvjeçare) vjeçare, duke filluar ky afat nga data e komisionimit të veprës, pra kur asetet bëhen operationale, ERE do të kushtëzohet nga ky afat në përcaktimin e vlefshmërisë së licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Korporata Elektroenergetike Shqiptare (KESH) sh.a.” në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga TEC-i lundruar i instaluar në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës, për një afat 2-vjeçar, duke filluar nga data e komisionimit të veprës, të përbërë nga dy gjenerues:

- a) “Tigri 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw.
- b) “Tigri 3”, me kapacitet të instaluar 60 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti